



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 55, datë 20.04.2021

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT E FONDIT PREJ 74'042'220 LEKË PA TVSH, TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.935, DATË 25.11.2020, NGA PJESA E FINANCUAR NGA GRANTET E FONDIT TË RINDËRTIMIT

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 25.11.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesat (pallat) dhe banesave individuale, në Bashkitë Durrës dhe Lezhë”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 74'042'220 lekë pa tvsh, të përfituar në zbatim Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 25.11.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe banesave individuale, në Bashkitë Durrës dhe Lezhë”, nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Gr. | Kap. | Progr-ami | Llog. Ekonom | Kodi i produktit | Emërtimi i projektit | Fondi në lekë |
|-----|-----|------|-----------|--------------|------------------|---|---------------|
| 1 | 00 | 6 | 04960 | 231 | 94902AB | Riforcim godinat 37, 39, Lagja 13, pranë pistës Iliria, kod GIS 5934,5933, godina 8 kate + bodrum , lagja nr.3 , Rruga Egnatia, kod GIS 27258 | 73,123,154 |
| | 00 | 6 | 04960 | 231 | 94902AB | Mbikqyrje | 820,338 |
| | 00 | 6 | 04960 | 231 | 94902AB | Kolaudim | 98,728 |



- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Buxhetit.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 20.04.2021



Nr. 92 / prot.
3

Durrës, më 21 .04. 2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 55 datë 20.04.2021 “Për miratimin e përdorimit e fondit prej 74’042’220 lekë pa tvsh, të përfituar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr .935, datë 25.11.2020, nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

